



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**19.04.2013**

## **NJOFTIM PËR PUBLIK**

**Prishtinë** - Lidhur me debatin e djeshëm të zhvilluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për ndërmarrjen “Trepça”, Agjencia Kosovare e Privatizimit shpreh keqardhjen që në këtë debat nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Agjencisë, të cilët janë kompetent në bazë të ligjit për të bërë një raportim të tillë. Po ashtu, Agjencia dëshiron të siguroj të gjitha palët e interesit se posedon të gjitha kapacitetit për të administruar me ndërmarrjen “Trepça”.

Bordi i Drejtoreve ka një strategji të qartë lidhur me riorganizimin e Trepçës, bazuar në ligjin për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe pasurisë së tyre. Ky proces tani ka është në fazën e kontraktimit të ofruesve të shërbimeve profesionale si dhe ka arritur të siguroj mbështetje teknike nga ekspert gjerman të sprovuar në riorganizime të suksesshme të gjigantëve metalurgjike në Evropë. Agjencia dëshiron t’i siguroj të gjitha Institucionet e Kosovës dhe palët tjera të interesit se plani gjithëpërfshirës i ri-organizimit të Trepçës do të jetë publik dhe transparent duke marrë miratimin e palëve të interesit dhe përfundimisht do t’i dorëzohet Gjykatës Supreme për aprovim. Edhe shtyrja e afatit për ri-organizimin e Trepçës është bërë me të vetmin qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve me të gjithë akterët relevant. Agjencia është administratori i vetëm i Trepçës, dhe këtu nuk vend për paragjykime rreth privatizimit. Agjencia është duke bërë planin për ri-organizimin e ndërmarrjes Trepça.

-----

Organet e rendit më 17 prill 2013 kanë ndaluar dy zyrtarë të AKP-së në zyrat qendrore të Agjencisë. Ndalimi i tyre është bërë pas hetimeve nga Prokuroria Speciale lidhur me një shitje në Valën 34 të privatizimit në vitit 2009. Menaxhmenti i AKP-së, konform Ligjit për Shërbyesit Civil tani më ka suspenduar zyrtarët e ndaluar nga organet e rendit deri në mbylljen e rastit dhe vendimin final të Gjykatës. Pa paragjykuar përfundimin e rastit, Agjencia është e vendosur të mbështesë organet e drejtësisë në mënyrë që të mbrojnë sundimin e ligjit, interesat e ndërmarrjeve shoqërore si administrator në mirëbesim dhe imazhin publik të Agjencisë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, ashtu si deri më tani, do të vazhdoj të përmbushë me përpikëri obligimet ligjore që dalin ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Rr. Ilir Konushevcu No.8,  
10 000 Prishtina, Kosovë,  
Tel: 038 500 400,  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org),  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**FUND**

Rr. Ilir Konushevci No.8,  
10 000 Prishtina, Kosovë,  
Tel: 038 500 400,  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org),  
**[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)**